

# Mediat e qyte tarë ve

## NJOHJE ME



Bloguesja kambxhiane Sopheap Chak e shfrytëzon blogun e saj në web për të ndarë informacione për të drejtat e njerëzve në Kamboxhë. <http://sopheapfocus.com/>

## Njohje me mediat e qytetarëve

### Po ndodh një ndryshim në mënyrën se si komunikojmë..

Vetëm para dhjetë vitesh të gjithë ne mësonim për botën për rreth nesh nga gazetat, televizioni dhe radioja.

Gazetarët profesionistë shkonin në vende të largëta dhe sillnin shkrime, fotografi dhe video të ngjarjeve që i kanë parë dhe të njerëzve që i kanë takuar.

Diku në darkë, bisedonim për këto shkrime me miqtë dhe familjet tona. Por, dhjetë vjet më parë shumë rrallë, ndoshta asnjëherë, komunikim drejtpërdrejt me vetë gazetarët. Pjesëtarët udhëheqës të shoqërisë shkruanin editoriale ku i shprehnin mendimet e tyre për çështje të ndryshme, por ne të tjerët

i ndanim mendimet dhe qëndrimet tona me një grup të vogël shokësh.

Shumë çka ka ndryshuar gjatë disa viteve të fundit. Duke iu falënderuar veglave të reja si p.sh. blogimit në web, tani është e lehtë të publikohet në Internet. Nga Turqia në Keni e gjerë në Bolivi, çdo ditë njerëzit si ju dhe unë fillojnë t'i ndajnë ngjarjet dhe mendimet e tyre me pjesën tjetër të botës.

Përderisa kjo formë e re e komunikimit tani është në dispozicion pa pagesë për çdokë, shumica e njerëzve që marrin pjesë jetojnë në lagje të pasura të qyteteve urbane.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të tregojë së çdokush që ka lidhje të Internetit mund të marrë pjesë në bashkëbisedimin e ri global. Kuptimi ynë për botën tani formohet jo vetëm

nga gazetat dhe televizioni, por edhe nga njëri tjetri.

### Në këtë Udhëzues:

- Blogimi është po aq i lehtë sa edhe e-maili 2
- Raste të studiuara 3
- Zbuloni zëra të rinj me RSS 4
- Publikimi i fotografive në web 5
- Publikimi i video në web 6
- Si ta bëni një podcast (podcast) 7
- Si përfundim 8



"Rising Voices" është iniciativë e "Global Voices" për medium të qytetarëve [[www.globalvoicesonline.org](http://www.globalvoicesonline.org)]. Duke i lidhur bloguesit, podcastuesit dhe video-krijuesit e apasionuar, nga e gjithë bota, besojmë se çdo faji nga çdo lagje mund të marrë pjesë në bashkëbisedimin on-line që po përhapet në mbarë globin. Ky udhëzues – Njohje me mediat e qytetarëve – është publikimi i parë nga një seri që ka për qëllim ta bëjë më të lehtë kuptimin e mediave të qytetarëve dhe pjesëmarrjen në to.



Edhe pse Venecuela është një shtet me ndasi të mëdha, bloguesit në Karakas – kryeqytetin e tyre, i ndajnë mendimet e tyre për ndryshimet që ndodhin përreth tyre.  
<http://www.to2blogs.com/>

## E lehtë si e-maili

Fjala “blog” është shkurtesë e fjalës “weblog” dhe ka të bëjë me një lloj të web-faqes që azhurohet në mënyrë kronologjike. Blogun mund ta paramendonit si e-mail. Për dallim, në vend që t’i dërgoni e-mail vetëm një personi, ju e publikoni njoftimin tuaj në web-faqe, ku mund të shihet nga çdokush në botë që ka lidhje Interneti.

Shumica e blogëve mundësojnë dhënien e komenteve, që do të thotë se njerëzve të tjerë u mundësohet të vendosin komente publike në çdo njoftim që e publikoni. Nëse p.sh., shkruani se Majkëll Xheksoni ishte këngëtar i madh që ka jetuar ndonjëherë, unë mund të vendos një koment, ku e shpreh mospajtimin tim me ju. Kjo është mënyra se si fillon biseda – një person e shkruan mendimin e tij ose të saj dhe pastaj të tjerët pajtohen ose nuk pajtohen me të. Disa nga weblog-et më të popullarizuara shpeshherë pranojnë mbi 100 komente çdo herë kur publikojnë diçka.

Bloget e para filluan të paraqiten nga mesi i viteve 1990, por blogimi nuk u popullarizua në mënyrë të vërtetë gjer diku nga viti 2003.

Këto ditë web-faqet e shumë gazetave, njerëzve të famshëm, bile edhe të kryetarëve gjithashtu përmbajnë weblog-e ku vendosen informata të reja çdo ditë apo çdo javë.

## Filloni për vetëm pesë minuta

Fillimi i një blogu është po aq i shpejtë sa edhe krijimi i një llogarie të e-mailit. Në të vërtetë, do të vëreni disa ngjashmëri

në mes të shkruarjes së e-mailit dhe shkruarjes së artikullit në blog. Dy doracakët e bashkangjitur me këtë udhëzues do t’ju tregojnë se si ta filloni dhe si ta mirëmbani një blog duke i përdorur shërbimet më të njohura pa pagesë, WordPress.com dhe Blogger.com.

Nuk ka rëndësi se cilin shërbim do ta zgjidhni – të dytë janë pa pagesë dhe ofrohen në shumë gjuhë. Dhe nëse ndërtoni mendje, zakonisht mund ta bartni blogun tuaj nga njëri lloj i shërbimit të tjetri.

Nëse jeni të padurueshëm për të filluar, tani mund ta kërceni pjesën e mbetur të këtij udhëzuesi dhe të shkoni menjëherë te njëri nga doracakët se si ta filloni një blog, qoftë me Wordpress.com apo Blogger.com.

Sidoqoftë, ka disa çështje që duhet t’i merrni parasysh para se të filloni.

## Pse duhet blogu?

Dhjetëra milionë njerëz nga mbarë bota tani kanë weblog-e. Ka blogë në mbi 100 gjuhë të ndryshme të cilat mbulojnë shumë më tepër çështje se sa mund të paramendonit. Sidoqoftë, pjesa më e madhe shkruhen nga Amerika Veriore, Azia Lindore, dhe Evropa Perëndimore. Edhe pse qasja në Internet është përhapur në pjesën më të madhe të rruzullit tokësor, pjesëmarrja në këtë bisedë të re, ngacmuese dhe online, kryesisht ka qenë e kufizuar në hemisferën veriore. Shpresojmë se këta udhëzues do t’ë paraqesin shtytje për pjesëmarrje më kreative nga njerëz të vendeve të ashtuquajtura në zhvillim.

## Katër hapa për të krijuar një blog

Cdo bloguesi i duhen katër gjëra për të filluar



### 1. Kompjuter

Ju duhet kompjuter, por nuk është e thënë të jetë i juaji. Përkrah se i tërë softueri për blogim është në Internet, mund t’i shkruani, t’i publikoni dhe t’i arkivoni të gjitha përmbajtjet tuaja online dhe t’u qaseni nga cilido qoftë kompjuter, në cilëndo qoftë Internet-kafe

### 2. Lidhje Interneti

Të kesh lidhje të shpejtë Interneti ju ndihmon nëse jeni të interesuar të punoni me audio dhe video, por edhe lidhjet shumë të ngadalshme mund të shërbejnë për blogim me tekst.

### 3. Softuer për blogim

Njëri nga vendimet e para që duhet të bëni është cilin lloj të softuerit do ta përdorni për ta krijuar blogun tuaj. “Rising Voices” ofron udhëzime për dy shërbimet më të popullarizuara: <http://blogger.com> dhe <http://wordpress.com>.

### 4. Mendime dhe ngjarje

Në fund ju duhet diçka për të cilën do të shkruani. Disa njerëz i trajtojnë bloget e tyre si revista publike - një mënyrë për t’i regjistruar përjetimet e tyre. Të tjerët dëshirojnë të diskutojnë për politikë ose t’i ndajnë mendimet e tyre për situatën në botë. Se për çka do të vendosni të shkruani varet nga ju, por ju japim disa sygjerime në faqen e ardhshme.

Njerëz të ndryshëm kanë blogje për arsye të ndryshme. Disa njerëz dëshirojnë t'i regjistrojnë jetërat e tyre për fëmijët e tyre, nipërit e tyre dhe stërnipërit e tyre. Edhe pse ne asnjëherë nuk do të takohemi me stër-stërnipërit tanë, ata do të jenë në gjendje t'i përfjetojnë jetërat tona duke falënderuar asaj që ne e kemi lënë prapa në Internet.

Për dallim nga fotografitë dhe revistat e shtypura të cilat zbehen dhe shkatërrohen pas një kohe, ajo që publikohet në Internet mund të mbijetojë përgjithmonë.

Të tjerët kanë blogje për shkak se janë të pasionuar për ndonjë temë, çështje apo hobi. Shumë blogje fokusohen në teknologji dhe politikë, ndërsa disa të tjerë fokusohen në letërsi, art dhe fotografi.

Ndërsa blogje të tjera sqarojnë se si të fillohet një biznes, si të investohen paratë, ose si të punoni në mënyrë më produktive. Blogjet fiktive, gjithashtu po bëhen gjithnjë e më të popullarizuara, për shkak se edhe shkrimtarët e dëshmuar, edhe ata të rinjtë, tani i publikojnë tregimet e tyre të shkurta në Internet.

Ka blogje që ju tregojnë se si të bëheni bujk më i mirë, si të bëheni prind më i mirë apo si të bëheni gitarist më i mirë. Në fakt, nëse jeni të interesuar për çkadoqoftë, sipas të gjitha gjasave ka blog për të.

(Në faqen tjetër do t'i shohim mënyrat për t'i gjetur blogjet që përputhen me interes tuaja.)

## Blogimi nuk do t'ju bëjë të famshëm apo të pasur

Disa njerëz fillojnë të blogojnë për shkak se duan të bëhen të famshëm. Edhe pse ka një grusht blogesh që lexohen nga dhjetëra mijëra njerëz për çdo ditë, shumica e blogjeve kanë 10-20 lexues të përkushtuar. Në ditët kur kishte vetëm disa televizione dhe radio stacione, çdokush i kërkonte 15 minutat e tij ose të saj të famës. Në erën e Internetit, çdokush është “i famshëm” për vetëm afër 15 veta. Por, përkrahja, inkurajimi dhe këshillat që vijnë nga ata 15 veta janë shumë më të vlefshme dhe jetëgjatë se çdo gjë që vjen nga 15 minutat e famës.

Ka shumë pak blogje që mund të bëjnë profit të madh nëpërmjet të reklamave. Shumica e bloguesve mund të presin të fitojnë 3-10 dollarë në muaj. Megjithatë, ekzistojnë edhe mënyra të tjera se si blogimi mund t'ju ndihmojë t'i realizoni ëndrrat tuaja. Shumë njerëzve u janë ofruar vende pune ose partneritete, për shkak të profesionalizmit që e kanë treguar në ndonjë temë në blogun e tyre. Ndërsa, disa të tjerë fillojnë të ndërtojnë autoritet dhe ftohen të flasin në konferenca

## Raste studimi:

### Hernán Casciari



Ky argjentinas mund të konsiderohet si blog-romansieri i parë. Dy blogjet e tij “Më shumë respekt, unë jam nëna jote”

dhe “Orsai” tani janë botuar si libra në shumë gjuhë.

<http://www.orsai.es/>

### Bongo Celebrity

Së shpejti do të zbuloni se shumë blogje u janë kushtuar njerëzve të famshëm dhe thashethemeve nga tabloidet. Kjo s'është diçka e re. Por, ku tjetër do të kishit gjetur blog të fokusuar posaçërisht te njerëzit e famshëm nga Tanzania? Shumica e publikimeve janë të shkruara në gjuhën Swahili.

<http://bongocelebrity.com/>

### Chilanga Banda

Chilanga Banda është një nga blogjet që shpesh quhen edhe ‘metro blog’, që d.t.th. blog që mbulon një qytet të caktuar, dhe në të shkruajnë më shumë njerëz. Në këtë rast, Chilanga Banda shkruan për ngjërjet e fundit në Meksiko Siti dhe vendet që duhet të shihen aty.

<http://www.chilangabanda.com/>

### Kubatana.net



Kubatana.net është një blog grupor që shkruhet nga aktivistë zimbabveanë që kërkojnë t'i jepet fund diktaturës së kryetarit Mugabe.

<http://kubatanablogs.net/kubatana/>

### LindjeJugVeriPerëndim

Bloguesi kinez Roland Soong është bërë një urë e rëndësishme në mes të Kinës dhe Perëndimit duke iu falënderuar blogut të tij, ku ai përkthen nga kinezishtja në anglisht, artikuj të ndryshëm të gazetave dhe postime nga blogje të ndryshme.

<http://zonaeuropa.com/weblog.htm>

## Akrobaci mendore



Bloguesi kenian i vendosur në Najrobi, Daudi Were mbulon një numër të jashtëzakonshëm të çështjeve, duke filluar nga politika keniane, duke vazhduar me

identitetin pan-afrikan e gjerë te teknologjia e avancuar.

[www.mentalacrobat.com/think/](http://www.mentalacrobat.com/think/)

## Tharum Bun



Tharumi shpesh konsiderohet si bloguesi i parë kambodhian. Revista e tij online paraqet një vështrim të rrallë në jetën e një kambodhiani të klasës

së mesme, në kohën kur vend i tij i shëron plagët nga era e dhunshme e Kmerëve të kuq dhe fillon të integrohet në ekonominë globale.

<http://tharum.info/>

## Konfused Kid

Një nga mijëra refugjatë irakianë që jetojnë në Jordan, ‘Konfused Kid’ ndihmon në sqarimin e ndërlikueshmërisë së shoqërisë irakiane dhe të botës arabe.

<http://ejectiraqikk.blogspot.com/>

## Desi Pundit

Desi Pundit është një blog tjetër grupor që i mbulon çështjet që kanë të bëjnë

me Indinë dhe shkruhet kryesisht nga blogues indianë që jetojnë nëpër botë.

<http://desipundit.com/>



## Blog Pasa en B.A.

Edhe autoritetet komunale – si p.sh. ata të Buenos Airesit - blogojnë.

<http://www.buenosaires.gov.ar/blog/pasaenbas>



ndërkombëtare. Pronarët e bizneseve mund të shkruajnë për prodhimet dhe shërbime e tyre në mënyrë që është më domethënëse (dhe më e lirë) se sa reklamimi tradicional. Në fund, nëpërmjet blogimit njiheni me njerëz që kanë interesa të ngjashme me të tuajat, kurse jetojnë me mijëra kilometra larg jush. Këto kontakte mund të jenë të dobishme në rast se ju duhet ndihmë, ose nëse keni vetëm ndonjë pyetje. Po t'i lexoni rastet e studimit nga faqja e mëparshme, mund të fitoni pasqyrë më të qartë se pse njerëzit fillojnë të blogojnë.

## Zgjidhni zëra të rinj

Në faqen e mësipërme janë dhënë disa shembuj të njerëzve që i shfrytëzojnë blogjet në mënyrë kreative. Nëse i vizitoni blogjet e tyre mund të fitoni pasqyrë të qartë për gjatësinë e publikimeve të tyre, komentet që vendosen aty, dhe stilin e shkrimit të tyre. Për dallim nga gazetaria standarde, blogimi ka tendencë që të jetë më joformale dhe në formë bisede. Resurs i vlefshëm për gjetjen e blogjeve që u përgjigjen interesave tuaja është web-faqja Technorati. Ajo është e ngjashme me Google, por në vend që ta kërkojë tërë Internetin, kërkon vetëm blogje në formë të medimeve të qytetarëve, fotografive dhe videove. Për shembull, le të themi se jetoni në Meksikë dhe dëshironi të gjeni blogje ku diskutohet për vendin tuaj. E tëra që duhet të bëni është ta shkruani adresën <http://technorati.com> në shfletuesin tuaj të Internetit dhe të shkruani "Mexico". Pastaj mund të kërkonit vetëm blogje, publikime, fotografi ose video. Nëse si rezultat ka shumë blogje dhe kjo duket e strëngarkuar, mund të kërkonit sipas qytetit konkret ose lagjes. Në rast të kundërt, nëse jeni adhures i i ndonjë lloji të muzikës, futbollistit apo librit, mund të kërkonit dhe të shihni me kë keni interese të përbashkëta. Do të bëjmë një shqyrtim të kësaj në udhëzuesin e quajtur "Hyrje në RSS".

## Zgjidhni lajmet tuaja

Njëri nga aspektet më të dobishme të blogjeve mund të duket edhe më i çuditshmi. Në vend që të vizitoni është dhjetëra web-faqe të ndryshme, tani mund t'i lexoni të gjitha publikimet më të reja nga të gjithë blogjet tuaja të preferuara në vetëm një faqe.

Ajo faqe quhet përmbledhës i feed-ëve dhe është një lloj Internet gazete e juaj personale - mund të zgjidhni se cilët artikuj do të paraqiten çdo ditë në bazë të blogjeve në të cilat jeni parapaguar. Kjo ndodh si rezultat i teknologjisë RSS (Really Simple Syndication). Çdo herë kur të publikoni ndonjë artikull në blogun tuaj, përmbajtja e tij paraqitet në vetë blogun dhe nëpërmjet RSS paraqitet në web-faqe të tjera ose nëpërmjet programeve softuerike në kompjuterin tuaj. E gjithë kjo do të ketë më shumë

kuptim kur ta kalojmë pjesën për mënyrën e shfrytëzimit të njërit nga lexuesit më të popullarizuar të feed-ëve - Google Reader - në udhëzuesin me emrin "Hyrje në RSS".

## Zbavituni

Nënkuptohet, më me rëndësi është që të kënaqeni gjatë blogimit dhe ai të paraqesë mënyrë të dobishme dhe zbavitëse të shpenzimit të kohës suaj. Tani mund t'i këmbëjmë përvojat dhe artikujt tanë me pjesën tjetër të botës dhe mund të informohemi për pjesën tjetër të botës nga njerëz si ne.



*Blogeri nga Tanzania Ndesanjo Maça shkruan në anglisht dhe gjuhën Svahali që të mund të komunikojë me publikun global dhe atë lokal.*  
[digitalafrica.blogspot.com](http://digitalafrica.blogspot.com)

## Abhijit Nadgouda sqaron se çka ka fituar nga blogimi.

1. Të shkruarit ju ndihmon që të mendoni më mirë dhe më thellë Kur e shkruani një mendim dhe e ndani me të tjerët, shpesh jeni të detyruar ta shqyrtoni atë në mënyrë më kritike dhe më të sinqertë.
2. Blogimi nuk ka rregulla Mund të jeni kreativ dhe me imagjinatë sa të dëshironi.
3. Arkivoni trurin tuaj Duke ndarë nga 30 minuta çdo ditë për t'i shkruar mendimet dhe përjetimet tona, mund të shohim prapa dhe të shohim se si jemi rritur dhe si kemi ndryshuar.
4. Lidhuni me njerëz të cilët përndryshe nuk do t'i kishit takuar Duke e shkruar blogun tuaj dhe duke i lexuar blogjet e të tjerëve, mund të takoni njerëz nga vende dhe kultura të tjera, të cilët kanë interesa të njëjta si ju.

<http://lorelle.wordpress.com/2007/08/06/why-blog/>

## Blogimi anonim

Ka shumë arsye për të bloguar me emrin tuaj të vërtetë, ku përfshihen kredibiliteti, sinqeriteti dhe reputacioni. Por, disa njerëz jetojnë në vende ku ajo që ato shkruajnë mund ta rrezikojë sigurinë e tyre. Për këtë arsye, "Global Voices" ka përpiluar një udhëzues se si të blogoni në mënyrë anonime dhe si ta fshehni identitetin tuaj online.



[advocacy.globalvoicesonline.org](http://advocacy.globalvoicesonline.org)

## Foto blogues



Bloguesi Tanzanian Philemon Msangi i plotëson publikimet e tij me fotografi mahnitëse.

[mwenyemacho.wordpress.com/](http://mwenyemacho.wordpress.com/)




Në fotoblogun e tij, Windy Skies, Anil P. dokumenton skena nga jeta e përditshme nga e gjithë India. Në fotografimin e mësipërme, një shitës kokosësh përgatit një pije freskuese.

<http://windyskies.blogspot.com/>



Blogu i Emmanuel Bensah, Akra gjatë ditës dhe natës (Accra by Day and Night), paraqet pamje nga jeta në kryeqytetin e Ganës. Shpesh, fotografitë – si shitësi i mësipërm i gazetave – ngjallin komente të shkurtëra për jetën në Akra.

[accradailyphoto.blogspot.com/](http://accradailyphoto.blogspot.com/)



Sabri Hakim paraqet një vështrim të Jordanit dhe Lindjes së Mesme që shumica prej nesh nuk do të kishin mundur ta përjetojnë.

<http://www.sabrihakim.com/>



<http://www.khosooof.com/> është njëri nga fotobloget më të njohura në Iran. Disa nga fotografitë tanime janë publikuar në BBC dhe Washington Post. Një fotografi e tij e një gruaje aktiviste në Iran, tërhoqi mbi 50,000 shikime për vetëm një ditë.

## Lëreni që kamera të flasë për ju

Siç thuhet shpeshherë, "një fotografi flet më shumë se njëmijë fjalë." Edhe pse shumica prej nesh kënaqen kur shkruajnë apo lexojnë, disa të tjerë preferojnë që të komunikojnë nëpërmjet fotografive. Me rënien e çmimeve të fotoaparateve digjitale dhe me faktin që shumica e telefonave celularë kanë kamera digjitale, këmbimi i fotografive në mes të miqve, anëtarëve të familjes dhe komuniteteve tona me pjesën tjetër të botës është bërë shumë i lehtë.

Shumica prej nesh nuk kanë dëshirë që të bëhen fotografë profesionalë, - ne thjeshtë kënaqemi duke dokumentuar atë që e shohim dhe duke i këmbyer ato fotografi me miqtë tanë dhe me çdokë tjetër që do të kishte interes t'i shihe ato. Tani ka disa web-faqe që mundësojnë publikimin pa pagesë të fotografive tuaja në Internet. Gjithashtu, fotografitë tuaja mund t'i publikoni edhe në blogun tuaj. Ndonjëherë mënyra më e mirë për të treguar një ngjarje është duke shfrytëzuar kombinimin e fotografive dhe të tekstit nën to.

## Kamerat tona na lidhin

Web-faqet si p.sh. <http://flickr.com> dhe <http://picasa.com> janë më shumë se vetëm vende ku mund t'i publikoni pa pagesë fotografitë tuaja. Ato gjithashtu janë edhe komunitete me grupe, forume dhe karakteristika të tjera sociale. Për shembull, ka shumë grupe të përkushtura fotografive sportive ose fotografive të veturave.

Gjithashtu, në fotografitë tuaja mund të veni informata gjeografike dhe ta shihni hartën e botës për të zbuluar se kush tjetër publikon fotografi në qytetet apo fshatrat afër apo larg jush.



Në këtë video të incizuar nga Xhej Dedman, bloguesi tajlandez Çiranuk sqaron në një punëtori në Bangkok, se si publikohet një video në Internet.

## Bëni filmin tuaj ose emisionin tuaj televiziv në Internet

Dhjetë vite më parë, thuajse të gjithë filmat dhe emisionet televizive bëheshin në Holivud, Kaliforni. Për ta parë një film duhej blerë një biletë të shtrenjtë për kinema. Shumë njerëz kishin ëndrra për t'u bërë aktorë, aktore apo regjisorë të famshëm, por atëherë nuk i kishim as paratë e as pajisjet për t'i realizuar ëndrrat tona.

Sot çdo gjë ka ndryshuar. Vetëm për 100 dollarë tani çdokush mund të bëjë një emision televiziv dhe ta shpërndajë atë online. E tëra që ju duhet është një video kamerë, një kompjuter, lidhje Interneti, dhe ide për një emision.

Në udhëzuesin e bashkangjitur me titull "Si të bëni Internet televizion" do të sqarojmë saktësisht si mund ta filloni emisionin tuaj televiziv në Internet dhe do t'ju tregojmë disa këshilla për të bërë video sa më bindëse. Do të flasim gjithashtu edhe për mënyrat se si mund t'i shfrytëzoni telefonat tuaj celularë për të incizuar video klipe të shkurtëra dhe pastaj t'i publikoni ato klipe në Internet. Disa web-faqe u ofrojnë madje edhe një shumë të vogël të hollash, njerëzve që në telefonat e tyre celularë inçizojnë video të ngjarjeve që ia vlen të jepen si lajme.

## Por, në fillim një vërejtje

Edhe pse inçizimi i videove dhe shikimi i tyre paraqet një lloj zbatimjeje, gjithashtu duhet edhe shumë kohë për ta prodhuar atë dhe për ta vendosur në web. Për shkak se lidhjet e Internetit në pjesën më të madhe të botës janë akoma të ngadalshme, shumë njerëzve u duhen mbi dy orë që të shkarkojnë një emision të vetëm televiziv në Internet.

Është e qartë, kjo nuk i përfshin ata që hyjnë në Internet nga ndonjë Internet kafe. Në anën tjetër, zakonisht nuk merr më shumë se 5 - 10 sekonda për ta parë një weblog.

Dhe nëse përdorni ndonjë RSS lexues si p.sh. Google Reader, atëherë për disa sekonda jeni në gjendje t'i lexoni përmbajtjet e fundit nga qindra ose madje edhe mijëra blogje.

Me fjalë të tjera, mendoni për atë se çfarë doni të arrini dhe deri te kush dëshironi të arrini? Cili është qëllimi i Internet televizionit tuaj dhe a jeni në gjendje t'i arrini po të njëjtat qëllime duke shfrytëzuar kombinimin e fotografive dhe të tekstit?

## Raste studimi:



Swajana është një përmbledhje videosh që ofrojnë ofrojnë këndvështrim për jetën e përditshme në Indi. Videot e fundit kanë

pasqyruar pelegrinazhin shpirtëror, programet paschkollore dhe një mulli në afrësi. <http://swajana.com>



Diçka për t'u dëshiruar (Something to be Desired) është një Internet komedi javore për jetën e një grupi studentësh të posadiploomuar që

jetojnë në Pitsburg të SHBA-ve. [www.somethingtobedesired.com](http://www.somethingtobedesired.com)



I gjallë në Meksikë (Alive in Mexico) është një emisionet e rralla në Internet, që publikat lokal dhe atij global ia

paraqet jetën në Meksikë. [www.aliveinmexico.org](http://www.aliveinmexico.org)

## Mbroni të drejtat e njeriut me telefonin tuaj celular

Edhe pse akoma në fillimet e tija, Video qendra WITNESS (WITNESS Video Hub) do të jetë web-faqe me pjesëmarrje, ku çdokush, çdokund mund të vendosë përmbajtje që ka të bëjë me drejtat e njeriut, që mund të përdoret për të bërë ndryshime. Nëse keni qenë dëshmitar i brutalitetit policor, ose i çfarëdo lloji të shkeljes së të drejtave të njeriut, dhe atë e keni inçizuar me telefonin tuaj celular ose video kamerë, kjo është mënyrë për të dokumentuar në mënyrë të sigurt dhe anonime çfarë ka ndodhur dhe për të ndihmuar t'i jepet fund kësaj.

[www.witness.org/hub](http://www.witness.org/hub)






## Podkaste të shkëlqyeshme:



Shou "The Kamla Bhatt Show" është një podcast i prodhuar në mënyrë të pavarur që paraqet aspekte të Indiës moderne për të cilat,

pjesa më e madhe e botës nuk kanë njohuri.

<http://www.kamlabhattshow.com>



"Tango City Tour" prodhohet në Buenos Aires nga dy adhurues të pasionuar të muzikës tango. Nëpërmjet këngëve dhe këngëtarëve që i

paraqesin në çdo podcast, mësojmë më shumë për Buenos Airesin dhe Argjentinën.

<http://www.tangocitytour.com.ar>



CitizenReporter.org me Bicyclemark është podcast javor i prodhuar nga një portugez-amerikan që jeton në Amsterdam. Çdo javë ai

mbulon çështje të re në ndonjë vend të ri, dhe shpesh i interviston bloguesit lokalë për t'i kuptuar më mirë lajmet e reja.

<http://www.bicyclemark.org/blog/>

## Çka ju duhet

- Një mikrofon – Mund t'ju shërbejnë edhe dëgjuese me çmim të lirë për Skype ose për bisedë nëpër Internet.
- Një kompjuter – I vendosur në vend të qetë ashtu që të ketë shumë pak zhurmë për rreth.
- Softuer për montazh – Në udhëzuesin me titull "Hyrje në podcast" do të sqarojmë se si ta përdorni programin softuerik pa pagesë, "Audacity", për të përpunuar dhe për të prodhuar podcast me pamje profesionale.
- Lidhje Interneti - Edhe pse në krahasim me videot, podcastet marrin shumë më pak kohë për t'u publikuar në Internet, prapëseprapë mund të publikuar një podcast dhe 30 minuta të tjera për ta shkarkuar ndonjë podcast tjetër.



Xhorxhia Popleuell, podkastuesja e parë nga Karibet, interviston një fëmijë me xhitë në Trinidad dhe Tobago. Në Radion e lirë të Karibeve ("Caribbean Free Radio"), ajo interviston artistë dhe personalitete lokale, me ç'rast ndan aspekte shumë pak të njohura të kulturës karibiane me pjesën tjetër të botës. <http://www.caribbeanfreeradio.com/blog>

## Merreni radion me vete

Ashtu siç çdokush mund të prodhojë emision televiziv nga dhoma e tij (e saj) e gjumit, gjithashtu mund ta prodhoni edhe radio programin tuaj që emitohet rregullisht dhe ta distribuoni nëpërmjet Internetit. Ky lloj i ri radio programit në Internet quhet 'podkast' – një kombim i fjalëve 'broadcast' (transmetim) dhe 'iPod', mp3 plejeri i popullarizuar.

Internet kelevizioni kërkon që të uleni përpara kompjuterit për ta parë emisionin. Podcasti, nga ana tjetër, është diçka që mund ta merrni me vete dhe ta dëgjoni në veturë, duke ecur, ose kur jeni të ulur në autobus apo metro. MP3 plejerët po bëhen gjithnjë e më të lirë, e gjithashtu edhe telefonat e rinj celularë mundësojnë dëgjimin e fajlave audio (siç janë podcastet) nëpërmjet dëgjuesve tuaja.

Edhe pse podcastet nuk ju mundësojnë t'i shihni lëvizjet e fytyrës së njerëzve e as fotografitë në lëvizje që i bëjnë videot aq tërheqëse, ato megjithatë ju mundësojnë t'i dëgjoni zërat e njerëzve, zërat nga vend i tij ose i saj, si dhe muzikën e tyre. Për dallim nga radio programet tradicionale që kërkojnë të jeni afër radios në kohë të caktuar të ditës gjatë çdo jave, podcastet mund t'i dëgjoni kurdo që dëshironi. Nëse konsideroni se një pjesë e programit është e mërziitshme, thjesht atë mund ta lëvizni përpara. A nuk do të ishte shumë mirë sikur të kishim mundësi t'i ecnim përpara të gjitha pjesët e mërziitshme të radio programeve?

## "Creative Commons" dhe kultura e ndarjes

Posa ta zbulojnë fuqinë e podcasteve, njerëzit shpesh dëshirojnë të fillojnë një podcast muzikor për t'i ndarë këngët e tyre të preferuara me të tjerët. Për fat të keq, shumica e këngëve kanë kufizime për shkak të drejtave autoriale, që do të thotë se fillimisht duhet t'i paguani një çmim të caktuar kompanisë muzikore të këngëtarit. Për fat të mirë, shumë këngëtarë që janë më shumë të interesuar t'i ndajnë këngët e tyre se sa të bëjnë para, po fillojnë t'i publikojnë këngët e tyre nën licencat e "Creative Commons", që ju mundëson t'i shfrytëzoni veprat e tyre nëse e theksoni emrin e tyre. Disa licenca "Creative Commons" madje ju mundësojnë që t'i ripërpunoni (remix) këngët e tyre dhe/ose të fitoni para nga to. Në udhëzuesin "Hyrje në podcastim" do të sqarohet disa mënyra për gjetjen e këngëve me licencë "Creative Commons". Një shembull i podcastit muzikor mund të gjendet në <http://indieish.com/revolution/>.



# “Mos i urreni mediat, krijoni media.”

## Përfundim



Deri tani pamë shumë mënyra ku shihet se si Interneti ka ndikim rrënjësor në mediat globale dhe në mënyrën se si komunikojmë

me njëri tjetrin. 10 vjet më pare, shumë pak njerëz kanë marrë pjesë në procesin e krijimit të mediave. Sot, mediat profesionale siç janë gazetaret, revistat, emisionet televizive dhe programet në radio, ekzistojnë akoma, por ato gjithashtu janë duke u plotësuar me një grup të ri të krijuesve të mediave – qytetarët e thjeshtë nga mbarë bota, siç jemi unë dhe ju.

Nuk është me rëndësi a jetojmë në ndonjë fshat të Tanzanisë ose në ndonjë qytet të madh si Peking – çdokush që ka lidhje Interneti tani mund të marrë pjesë në procesin e krijimit të mediave. Nëse konsiderojmë se gazetaret e komunitetit tonë nuk e përmbushin atë që presim nga ata, mundemi t’u tregojmë se si mund ta bëjnë atë më mirë.

Kjo botë tërheqëse e blogëve, podkasteve dhe e videove online, shpesh herë quhet “media e qytetarëve”. Sipas të gjitha gjasave, ajo nuk do ta zëvendësojë gazetarinë tradicionale – akoma kemi nevojë për artikujt hulumtues të profesionistëve të trajnuar. Mirëpo, mediat online, që i mundësojnë çdokujt të marrë pjesë dhe ta japë mendimin e tij, mund të jenë hapi i parë drejt një bote që mundëson pjesëmarrje më të madhe, llojllojshmëri më të madhe dhe transparencë më të madhe.

## Hapi i ardhshëm, merr pjesë

Shpresojmë se ky udhëzues fillestar u mundësoi që t’i kuptoni më mirë mediat e qytetarëve. Shpresojmë se ndjeheni të inspiruar të kaloni pak kohë për të njohur disa blogje, podkaste dhe emisione televizive në Internet, që i përmendëm si raste studimi. Shpresojmë se do të kërkonti edhe media të tjera të qytetarëve. Dhe mbi të gjitha, shpresojmë se ky udhëzues do t’ju inspirojë që të vazhdoni me udhëzuesin tjetër dhe të mësoni se si të merrni pjesë.

## Bashkangjiteti bisedës globale



“Global Voices” është një komunitet entuziastësh për media të qytetarëve nga e gjithë bota, që bëjnë përmbledhje, organizim, dhe zgjerim të bisedave ndërkombëtare online. Pa

marrë parasysh se a kërkonti podkaste nga Japonia apo fotografi magjepsëse nga Maqedonia, “Global Voices” është një fshat online i njerëzve të zakonshëm që i ndajnë ngjarjet, fotografitë dhe mendimet e tyre nga pjesa e tyre e botës me ato tuajat.

Shpresojmë se do të merrni pjesë në bisedë.

[www.globalvoicesonline.org](http://www.globalvoicesonline.org)

## Bloguesi veteran Xhoi Ito ua rekomandon këto pesë këshilla të gjithë bloguesve

1. Jini modest – Interneti është një vend i madh dhe ka gjasa shumë të mëdha që dikush tjetër të dijë më shumë se ne për çështjen për të cilën ne shkruajmë. Kjo nuk do të thotë se nuk duhet të shkruani për atë, por përpiquni që të mos duket sikur jeni të gjithëdijshëm.
2. Kërkonti ndihmë – Nëse jeni duke u ballafaquar me ndonjë problem për të cilin ju duhet ndihmë që ta kuptoni, pyetni lexuesit tuaj. Kjo gjithashtu paraqet edhe mënyrë të mirë për ta filluar bisedën.
3. Merrni qëndrim - Web-faqet e tjera si Wikipedia kërkojnë paanshmëri dhe objektivitet, por webloget janë vende të shkëlqyera për t’i shprehur mendimet e tuaja, por edhe për të qenë tolerant ndaj mendimeve të të tjerëve që mund të ndryshojnë nga ato tuajat.
4. Lidhuni - Para se të publikoni diçka, kërkonti nëpër blogje të tjera. Nëse shihni se të tjerët diskutojnë për temë të ngjashme, atëherë lidhuni me postimet e tyre. Përpiquni të merrni pjesë në bisedë, në vend që të qëndroni si i hypur në foltore, ku flisni vetëm ju.
5. Shkruani herët, shkruani shpesh - Fokusohuni në komunikimin e qartë të mendimeve tuaja. Është mirë t’i zbatoni rregullat e drejtshkrimit dhe të gramatikës, por më me rëndësi është që të shkruani dhe të merrni pjesë.

[http://joi.ito.com/archives/2005/10/10/blogging\\_style.html](http://joi.ito.com/archives/2005/10/10/blogging_style.html)

“Rising Voices” është iniciativë për medium qytetarësh i “Global Voices” dhe është mundësuar duke iu falënderuar përkrahjes së Fondacionit John S. dhe James L. Knight. Udhëzuesit për softuerët janë vënë në dispozicion pa pagesë nga FLOSSManuals.net.



 Knight Foundation

Jeni të lirë që këtë material ta kopjoni, distribuoni dhe transmetoni, si dhe të krijoni materiale të reja nga to, poqese e përmendni në mënyrë adekuate “Rising Voices”.



Përkthyer nga:  
Metamorphosis Foundation  
[www.metamorphosis.mk](http://www.metamorphosis.mk)

 METAMORPHOSIS  
Foundation for sustainable ICT solutions